



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2023:222740

Datë: 22.04.2024

Numri i dokumentit: 05601782

PAKR.nr.173/24

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS - Departamenti për Krime të Rënda me kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Hashim Çollaku - kryetar i kolegjit, Kadrije Goga Lubishtani dhe Skender Çoçaj - anëtarë të kolegjit, me praktikanten gjyqësore Erna Stublla si procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të akuzuarit F. Sh për shkak të veprës penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 267 par.2 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK-së), duke vendosur sipas ankesës së mbrojtëses të akuzuarit F. Sh, av. Njomza Hoxha, e ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Pejë - Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.3/2024 i datës 26.01.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën 12.04.2024 mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e mbrojtëses të akuzuarit F. Sh, av. Njomza Hoxha, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Pejë - Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.3/2024 i datës 26.01.2024, VËRTETOHET.

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Pejë- Departamenti për Krime të Rënda, me aktgjykimin PKR.nr.3/2024 të datës 26.01.2024, të akuzuarin F. Sh për shkak të veprës penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 267 par.2

të KPRK-së, e ka shpallur fajtor dhe i ka shqiptuar dënim me burgim në kohëzgjatje dy (2) vite, si dhe dënim me gjobë në shumën njëmijë euro (1000 €). Në dënim do të i llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim prej dt. 18.10.2023 e tutje.

Dënimet e cekura do të ekzekutohen më së largu në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Është udhëzuar i akuzuari që nëse nuk mund apo nuk dëshiron të paguaj dënimin me gjobë brenda afatit të caktuar si më lartë, atëherë dënimi me gjobë do ti zëvendësohet në dënim me burg duke iu llogaritur një ditë burg për çdo njëzet euro (20 €) të gjobës.

ta paguaj në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve pasi aktgjykimi të merr formën e prerë.

Konform nenit 267 par.5 të KPRK-së të akuzuarit i është konfiskuar substanca narkotike e llojit “Heroin”, në peshë të përgjithshme 70,34 gram, të sekuestruara në bazë të nr. te rastit R-2023-XI-DKKO-HTN-PE-79 dhe nr. reference 08/1-04/1717/2023 të datës 18.10.2023, e cila pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi do të asgjësohet.

Është obliguar i akuzuari që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën pesëdhjetë euro (50 €), si dhe në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit të paguaj shumën pesëdhjetë euro (50.00 €), të gjitha këto në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ankesë ka ushtruar:

Mbrojtësja e të akuzuarit F. Sh, av. Njomza Hoxha dhe av. Admir Salihu, për shkak të vendimit mbi sanksionin penal, me propozimin që Gjykata e Apelit e Kosovës ta ndryshojë aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Pejë - Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.3/2024 i datës 29.01.2024, ashtu që ndaj të akuzuarit F. Sh të shqiptojë një dënim më të butë.

Prokuroria e Apelit me parashtresën PPA/I.nr.168/2023 e datës 15.03.2024 ka propozuar që të refuzohet si e pabazuar ankesa e mbrojtëses të akuzuarit F. Sh, av. Njomza Hoxha, e ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Pejë - Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.3/2024 i datës 29.01.2024, ndërsa aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Gjykata e Apelit caktoi dhe e mbajti seancën e kolegjit në pajtim me dispozitën e nenit 390 të KPPK-së, në të cilën kanë marrë pjesë i akuzuari F. Sh dhe mbrojtësja e tij av. Njomza Hoxha, ndërsa Prokurori i Apelit, ndonëse të njoftuar me kohë dhe në mënyrë të rregullt nuk prezento

në seancë. Në seancën e kolegjit mbrojtësja e të akuzuarit av. Njomza Hoxha ka deklaruar se qëndrojmë në tërësi pranë ankesës së parashtruar në Gjykatën e Apelit. Kërkoj Gjykata e Apelit të zbut dënimin ndaj të mbrojturit të saj, pasi që i njëjti ka pranuar fajësin,ë që në fillim të procedurës dhe është mbajtes i familjes. I akuzuari F. Sh ka deklaruar se mbështet avokaten e tij.

Gjykata e Apelit, e shqyrtoi aktgjykimin e ankimuar, detyrimisht në kuptim të dispozitës së nenit 394 par.1 të KPPK, vlerësoi pretendimet ankimore të mbrojtëses të akuzuarit F. Sh, av. Njomza Hoxha së bashku me shkresat tjera të lëndës dhe pas vlerësimit të njëjtave, gjeti se:

Ankesa është e pabazuar.

Pretendimet ankimore të mbrojtëses të akuzuarit F. Sh, av. Njomza Hoxha

Mbrojtja pretendon se Gjykata e shkallës së parë me rastin e vendosjes lidhur me sanksionin penal dhe lartësinë e dënimit nuk i ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese për të akuzuarin. Sipas mbrojtjes, Gjykata e shkallës së parë përpos pranimin të fajësisë dhe faktit që i akuzuari është baba i katër fëmijëve, nuk i mori fare parasysh rrethanat e tjera lehtësuese si: rrethanat personale dhe karakterin e personit të dënuar (faktin se i akuzuari asnjëherë më parë nuk ka qenë i dënuar për vepra penale të narkotikëve), moshën e personit të dënuar (mosha e re), bashkëpunimin e përgjithshëm të personit të dënuar me gjykatën, bashkëpunimin vullnetar të personit të dënuar në hetimin ose ndjekjen penale, keqardhjen e shfaqur nga personi i dënuar, sjelljen e personit të dënuar pas kryerjes së veprës penale, premtimin se në të ardhmen nuk do të kryej vepra të tjera, faktin që është mbajtes i familjes dhe duhet të kujdeset për fëmijët e tij duke siguruar të ardhura monetare për shkollimin dhe mirëqenien e tyre. Mbrojtja vlerëson se duke marrur parasysh këto rrethanat dënimi i shqiptuar me burgim dhe lartësia e dënimit me gjobë është mjaft i rëndë.

Për më tepër, mbrojtja konsideron se Gjykata e shkallës së parë nuk ka marrur parasysh as rrethanat për zbutjen e dënimit sipas nenit 71 par.1 pika 1.3 si dhe neni 72 par.1 pika 1.4 të KPRK-së, pasi që edhe sipas ligjeve tona aktuale decidivisht thuhet se qëllimi i dënimit është përmirësimi dhe rehabilitimi i të pandehurit që në të ardhmen të mos kryej vepër penale e jo dëmtimi i tij në masë të madhe. Në rastin konkret mbrojtja vlerëson se me një dënim me të vogël do të arrihet qëllimi i dënimit.

Andaj, sipas mbrojtjes duke marrur parasysh rrethanat e lartcekura ka vend që dënimin i shqiptuar të zbutet nën kufijtë e paraparë ligjor sipas dispozitave ligjore të KPRK-së, konkretisht nenit 71 dhe 72.

Vlerësimi i Gjykatës së Apelit

Edhe pse aktgjykimi i shkallës së parë nuk ankimohet për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, Gjykata e Apelit të njëjtin lidhur me shkeljet e tilla e shqyrtoi sipas detyrës zyrtare dhe konform nenit 394 par.1 të KPPK-së, gjeti se i njëjti nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale e as shkelje të tjera të cilat detyrimisht do të kushtëzonin anulimin e tij.

Po ashtu, me ankesë nuk kontestohet as gjendja faktike të cilën e ka vërtetuar Gjykata e shkallës së parë, prandaj as në këtë drejtim çështja nuk ka qenë objekt vlerësimi i kësaj Gjykate (pasi që nuk mund të kontestohet aktgjykimi përkitazi me këtë bazë ankimore, me që i akuzuar ka pranuar fajësinë). Prandaj, aktgjykimi u vlerësua vetëm lidhur me pretendimet ankimore të mbrojtëses të akuzuarit F. Sh, av. Njomza Hoxha, sa i përket vendimit mbi sanksionin penal.

Vlerësimi i Gjykatës lidhur me vendimin mbi dënim

Duke shqyrtuar aktgjykimin e ankimuar përkitazi me vendimin mbi dënimin, Gjykata e Apelit konstaton se pretendimet e mbrojtëses të akuzuarit F. Sh, av. Njomza Hoxha janë të pabazuara.

Gjykata e shkallës së parë me rastin e caktimit të dënimit i ka vlerësuar rrethanat të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësisë së dënimit në pajtim me nenin 69 dhe 70 të KPRK-së, duke vlerësuar si rrethanë lehtësuese faktin se i akuzuari ka pranuar fajësinë qysh në fillim dhe është baba i katër fëmijëve, ndërsa si rrethanë rënduese ka vlerësuar faktin se i akuzuari më parë ka qenë i dënuar për disa vepra penale dhe atë me katër aktgjykime si vijon: P.nr.38/2020 i dt. 31.08.2020 për veprën penale nga neni 366 të KPPRK-së është dënuar me gjobë, P.nr.633/2023 të dt. 25.10.2023 për veprën penale nga neni 184 të KPRK-së është dënuar me dënim me kusht, P.nr.101/2023 i datës 29.10.2023 për veprën penale nga neni 248 të KPRK-së është dënuar me dënim me kusht, si dhe P.nr.122/2011 i dt. 24.05.2011 për veprën penale nga neni 328 të KPRK-së është dënuar me dënim me gjobë, të cekura si në vërtetimin E1/17/2024/DEPQ/KGJK të datës 12.01.2024. Andaj, bazuar në këto rrethana Gjykata e shkallës së parë ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimin të ankimuar.

Një vlerësim të këtillë të rrethanave relevante për matjen e dënimit si të drejtë dhe të ligjshëm e pranon edhe kjo Gjykatë dhe gjen se Gjykata e shkallës së parë drejtë dhe në mënyrë të plotë i ka vlerësuar rrethanat të cilat ndikojnë në caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit. Ndërsa, pretendimi i mbrojtëses të akuzuarit se Gjykata e shkallës së parë nuk ka vlerësuar fare rrethanat

e tjera lehtësuese të theksuara si në ankesën e saj, është pretendim i pabazuar pasi që në rastin konkret fakti që i akuzuari është baba i fëmijëve dhe ka obligim të përkujdeset ndaj të njëjtëve veç se kanë qenë objekt i vlerësimit të Gjykatës së shkallës së parë, ndërsa rrethana lehtësuese e personalitetit të njëjtit e pretenduar nga mbrojtja nuk mund të aplikohet për shkak se Gjykata e shkallës së parë veç se e ka vërtetuar që i akuzuari ka qenë i dënuar më parë për kryerjen e veprave të ndryshme penale, rrjedhimisht si rezultat i këtyre gjetjeve ë akuzuarit Gjykata e shkallës së parë i ka shqiptuar dënimin përkatës. Të gjitha këto rrethana edhe sipas vlerësimit të kësaj Gjykate janë bazë e mjaftueshme për arsyetimin e dënimit të shqiptuar nga Gjykata e shkallës së parë si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar.

Prandaj, kjo Gjykatë vlerëson se dënimi i shqiptuar ndaj të akuzuarit nga ana e Gjykatës së shkallës së parë është në harmoni me intensitetin e rrezikshmërisë shoqërore të veprës së kryer penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit dhe më intensitetin e rrezikimit apo pasojave të shkaktuara dhe se më të do të mund të parandalohet i akuzuari nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, si dhe do të parandalohen personat tjerë nga kryerja e veprave penale.

Nga arsyet e lartcekura u vendos si në dispozitive të këtij aktgjykimi konform nenit 401 të KPPRK-së.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
Departamenti për Krime të Rënda
PAKR.nr.173/24, datë 12.04.2024

Praktikantja gjyqësore
Erna Stublla

Anëtarët e kolegjit
Kadrije Goga Lubishtani

Kryetar i kolegjit
Hashim Çollaku

Skender Çoçaj